



FEDERATA E VOLEJBOLLIT E KOSOVËS
VOLLEYBALL FEDERATION OF KOSOVA
ODBOJKAŠKA FEDERACIJA KOSOVA

Tel. & Fax.: +381 38 226 825

E-mail: info@fvk-ks.org

www.fvk-ks.org

RREGULLORE E BRENDSHME

e Federatës së Volejbollit të Kosovës



KAPITULLI I

VEPRIMTARITË ZYRTARE DHE KUSHTET TEKNIKE

NENI 1.

Mënyra e zhvillimit të çdo veprimtarie kombëtare apo ndërkombëtare volejboli që do të zhvillohet në vëndin tonë përcaktohet në bazë të „Rregullores së Veprimtarive Zyrtare Kombëtare ” e cila hartohet dhe miratohet nga Bordi i Federatës së Volejbollit të Kosovës për çdo sezon sportiv, nga Rregullorja e Brendshme e FVK, Rregullorja Teknike e Lojës së Volejbollit e FIVB, si dhe nga të gjitha udhëzimet zyrtare që dërgohen nga FVK.

1.1 Veprimtaritë Zyrtare Kombëtare që organizohen nga FVK ose nga subjekte të deleguara prej saj, janë si më poshtë vijon:

- a. KAMPIONATI KOMBËTAR: meshkuj, femra, të rinj, të reja, para të rinj, para të reja.
- b. KUPA E KOSOVËS: meshkuj, femra,.
- c. KUPA E FVK: meshkuj, femra,.
- d. SUPER KUPA: meshkuj, femra,
- e. AKTIVITETET E BEACH VOLEJBOLLIT: meshkuj, femra, të rinj, të reja para të rinj, para të reja e dhe festivali për fëmijë.

1.1.1 Vendi, data, dhe mënyra e zhvillimit të çdo veprimtarie përcaktohet në kalendarin sportiv kombëtar, në përputhje me strukturën organizative miratuar nga Bordi i FVK-se.

1.2 Kalendar Kombëtar është i detyrueshëm të zbatohet nga të gjitha skuadrat e volejbollit. Ai mund të ndryshojë vetëm në rastet e mëposhtme:

- a. Ngjarje të jashtëzakonshme (epidemi, tërmet, përmytje, gjëndje të jashtëzakonshme, mungesë e Rendit publik, mungesë e sigurisë publike), të konfirmuara nga institucionet përkatëse qëndrore shtetërore.
- b. Kur skuadra zhvillon ndeshje zyrtare ndërkombëtare brënda dhe jashtë vëndit, atëhere ndeshja e radhës sipas kalendarit do të zhvillohet 2-3 ditë para dhe jo më vonë se 48 orë pas kthimit të skuadrës në vënd.

c. Për aktivitetet miqësore ndërkombëtare Klubi duhet të njoftojë jo më vonë se dy javë përpara në FVK, për datën e zhvillimit të aktivitetit miqësor ndërkombëtar, i cili mund të konfirmohet nga FVK vetëm në qoftë se nuk ndikon në zhvillimin normal të ndeshjeve sipas Kalendarit sportiv.

1.3 Klubet sportive nuk kanë të drejtë të ndryshojnë sallën dhe orarin e ndeshjeve të Kampionatit Kombëtar, pa miratimin e FVK.

1.4 Vendi organizator i veprimtarive me sistem grumbullimi mund të ndryshojë para fillimit të aktivitetit, vetëm orarin e ndeshjeve me miratimin e FVK.

1.5 Të gjitha veprimtaritë kombëtare zyrtare të Superligave, Kupa e Kosovës dhe Kupa FVK-se do të zhvillohen detyrimisht në pallate sporti dhe palestra sportive të miratuara nga FVK-ës.

1.5.1 Në infrastrukturën e pallateve të sportit apo palestrave sportive ku do të zhvillohen ndeshjet e veprimtarive zyrtare kombëtare apo ndërkombëtare, Klubi pritës duhet të ketë dhe pajisjet e mëposhtme:

1. Flamurin Shtetëror dhe flamurin me logon e FVK.
2. Flamujt e Klubeve apo Shoqatave Sportive.
3. Flamujt për gjyqtarët anësorë.
4. Qendrën e zërit dhe protokollet e ndeshjeve dhe fletëvendosje për skuadrat
5. Tabelën e pikëve, numrat për ndrrimet e lojtarëve, fshirëset e parketit e sinjalizuesin për pushimet e ndrrimet e lojtarëve, shërbimin internet.

1.5.2 Pallatet e sportit dhe palestrat sportive të miratuara nga FVK sipas qyteteve respektive ku do të zhvillohen veprimtaritë zyrtare të volejbollit janë:

- Pallate sporti: Prishtine, Peje, Prizren, Gjakove, Gjilan, Mitrovicë, Ferizaj, Therrande, Vushtrri, Drenas, Kastriot, Malisheve, Lypjan, Bardhosh, Diloni Benz

- Palestrat sportive: Fakulteti i Kult. Fizike, Malisheve, Kolegji AAB t dhe Skenderaj (salla e re e Qendres së Kompetences)

1.5.3 Garat e play off-it, play-autt, finalët e kupave, detyrimisht, do të zhvillohen në pallate sporti.

1.5.4 Veprimtaritë Kombëtare zyrtare të ligave të para, të rinjeve dhe të rejave mund të zhvillohen edhe në sallat e shkollave të cilat paraprakisht janë miratuar nga FVK-ës.

1.6 Në të gjitha veprimtaritë Zyrtare Kombëtare të të gjitha niveleve, Klubi Pritës sipas Kalendarit duhet të ketë në dispozicion MJEKUN e Ndeshjes, i cili duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë ndeshjes, në gadishmëri për t' i dhënë ndihmën e parë të dyja skuadrave.

1.7 Të gjithë pallatet e sportit e palestrat sportive duhet të disponojnë të gjitha pajisjet e nevojshme për zhvillimin e ndeshjeve. Të kenë dhoma zhveshjeje dhe ambiente normale hidrosanitare, për të dyja skuadrat gjyqtarët dhe zyrtarët

1.8 Të gjitha veprimtaritë zyrtare që përfshihen në Kalendarin Kombëtar zhvillohen detyrimisht në prani të organeve të ruajtjes së Rendit Publik. (Policia e Kosovës)

Klubi pritës në kalendarin e aktivitetit, përfshirë dhe klubet apo shoqatat sportive respektive janë përgjegjës për:

- a. Sigurimin e bazës materiale për ndeshje në përputhje me standardet e parashikuara në Rregulloren Teknike të FIVB dhe Rregulloren e Brëndëshme të FVK.
- b. Sigurimin e energjisë elektrike për sallën ku do të zhvillohen ndeshjet.
- c. Sigurimin e pranisë së forcave të Rendit Publik gjatë gjithë kohës së zhvillimit të aktivitetit. Sigurimin e nje kompjuteri dhe shërbimin e internetit.
- d. Të siguroj menaxhimin e drejtë të tifozëve të skuadrës së tij në respektimin e rregulloreve karshi gjyqtarëve dhe zyrtarëve të ndeshjes

1.9 Në të gjitha rastet kur kushtet e sallës, ndriçimi ose kushtet atmosferike bëjnë të pamundur teknikisht zhvillimin e ndeshjes, atëherë do të procedohet sipas rregullores Teknike.

1.9.1 Kur ndeshja e kalon kufirin e ndërprerjes prej 4 orësh, ajo do të përsëritet Ditën e nesërme, duke filluar nga fillimi. Ora e fillimit të ndeshjes do të përcaktohet vetëm nga gjyqtarët e ndeshjes, pas konsultimit me kapitenët e të dyja skuadrave dhe delegatin Teknik.

1.9.2 Ndeshja që nuk përfundon sipas pikës 1.9.1, do të zhvillohet para ndeshjes pasardhëse në një vënd dhe datë, që do të caktohet nga FVK

1.9.3 Të gjitha skuadrat e super ligen m-f pjesmarrse në Kampionatin Kombëtar për të Rritur dhe të Rritura duhet të paguajnë taksën e pjesmarrjes prej 200 € për një gjysem sezon sportiv, jo më vonë se 20 ditë para fillimit të Kampionatit Kombëtar respektiv. Ndersa per ligen e pare 100 euro.

1.9.4 Skuadrat që nuk do të respektojnë periudhën e sipërpërmendur mund t' a paguajnë atë kundrejt gjobës prej 50 € deri në 5 ditë para fillimit të fazës së parë.

1.9.5 Pas kësaj periudhe skuadra e cila nuk ka paguar taksën e rregjistrimit, përjashtohet nga veprimtaria e Kampionatit Kombëtar në vazhdim.

1.9.6 Në të gjitha veprimtaritë zyrtare kombëtare nuk lejohet që një Klub / të ndryshojë topin apo topat e lojës të miratuara nga FVK.

1.9.8 Të gjitha klubet që janë antare të FVK, kur duan të organizojnë aktivitete miqësore Volejboli apo Beach Volley me dy skuadra, duhet detyrimisht të lajmërojnë FVK. për zhvillimin e aktivitetit, ndërsa për aktivitetin me tri e me shumë skuadra duhet detyrimisht të mirret leja Miratimit për zhvillimin e aktivitetin lëshuar nga FVK.

1.9.9 Asnjë subjekt publik apo privat i cili nuk është antar i FVK nuk ka të drejtë të organizojë veprimtari kombëtare volejboli ose beach-volley, pa miratimin dhe lejen e lëshuar nga FVK.

1.10. Në rast të mos respektimit të neneve 1.9.8; 1.9.9; të gjitha klubet, shoqatat apo subjektet publike apo private, që do të organizojnë veprimtari pa marrë më parë lejen nga FVK, do të gjobiten me shumën nga 500 €

KAPITULLI II

ORGANIZIMI I VEPRIMTARIVE

NENI 2. Klubi pritës në kalendarin e aktiviteteve ose klubi të cilit i është deleguar organizimi i një aktiviteti duhet të garantojë marrjenë të gjitha masave të domosdoshme për zhvillimin normal të ndeshjeve. Ata do të përgjigjen për pritjen, përcjelljen e skuadrave, gjyqtarëve e delegatit teknik.

2.1 Për strehimin e skuadrës në bazë të njoftimit zyrtar të dërguar nga skuadra mike përgjigjet Klubi sportiv pritës. Në rast reklamimi detyrimisht ai duhet të shoqërohet me gjithë dokumentacionin zyrtar përkatës.

2.2 FVK nuk përgjigjet për sigurimin e automjeteve të udhëtimit për skuadrat, gjyqtarët e delegatit teknik.

2.3 Vonesat në oraret e zhvillimit të ndeshjeve të caktuara si dhe vonesat e korrespondencës postare nuk merren parasysh.

2.4 Në fillim dhe në mbarim të çdo veprimtarie do të zhvillohet ceremonia e hapjes dhe e mbylljes. Skuadrat janë të detyruara të marrin pjesë me të gjithë efektivin e saj të regjistruar

në protokollin e ndeshjes. Në rast se një skuadër e cila duhet të jetë sipas protokollit në ceremoninë e mbylljes nuk paraqitet, ajo dënohet për mungesë në procedurat zyrtare të FVK dhe gjobitet me 100 €.

2.5 Për ceremoninë e hapjes ose të mbylljes të një veprimtarie përgjigjet Klubi organizator i veprimtarisë.

2.6 Në të gjitha veprimtaritë zyrtare kombëtare Klubi pritës duhet të likujdojë para zhvillimit të ndeshjes shpërblimet teknike për grupin e gjyqtarëve .

2.6.1 Shpenzimet për udhëtimin, dietat dhe shpërblimin teknik të Delegatit, dy gjyqtarëve, sekretarin, gjyqtarët anësorë dhe pikëshënuesin e ndeshjes në përputhje me rregulloren e brëndëshme, duhen të likudohen nga klubi pritës.

Në rast të mos likujdimin të pagesave të këtij grupi gjyqtarësh para zhvillimit të ndeshjes, klubi pritës dënohet sipas nenit 2.6 për shkelje të rregullores duke humbur ndeshjen 0-3 dhe 0-75 dhe gjobitet me 100 €.

2.6.2 40 (katerdhjete) minuta para fillimit të ndeshjes delegati teknik ose gjyqtarët duhet të kontrollojnë dokumentacionin e skuadrave (listat e federimit dhe liçencat).

Ata duhet të kontrollojnë rregullsinë e dokumentave (firmat dhe vulat përkatëse), pastaj të japin konfirmimin për rregjistrimin e tyre në protokollin e ndeshjes.

Personat që nuk janë të federuar ose nuk kanë liçencë, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndeshje dhe nuk lejohen të futen të hapësirat e zhvillimit të lojës, si dhe në të gjithë ambientin ku zhvillohet ndeshja.

2.7 Liçencat e skuadrave duhet të qëndrojnë në tavolinën e sekretarisë nga fillimi deri në përfundim të ndeshjes.

2.7.1 Në rast se ndonjë lojtari apo trajneri i humb licenca, atëhere drejtuesit e Klubit duhet të njoftojnë menjëherë në FVK për zëvendësimin e saj (sipas taksës përkatëse).

2.7.2 Në rast të mos zëvendësimit të licencës në kohën e duhur lojtari apo trajneri duhet të paraqiten në ndeshje me listën e federimit dhe me një dokument identifikimi, Pasaportë ose Kartë Identiteti.

Në këtë rast trajneri lëshon para ndeshjes një deklaratë, në praninë e gjyqtarëve të ndeshjes, duke marrë përgjegjësinë e sanksioneve, që mund të rrjedhin nga identifikimi i plotë i dokumentacionit nga institucioni zyrtar përkatës dhe FVK.

2.7.3 Gjyqtarët para ndeshjes duhet të kontrollojnë dokumentat e këtyre personave:

- a. Lojtarë deri: 12 (listë federimi+liçencë)
- b. Trajnerë: Trajneri dhe 2 ndihmes (listë federimi + liçencë)
- c. grupi mjekesor: nje masazher dhe nje mjek:

Të gjitha liçencat duhet të jenë me fotografinë përkatëse të çdo personi dhe të miratuara nga FVK për çdo sezon sportive.

2.8 Në tavolinën e sekretarisë duhet të qëndrojnë vetëm sekretari i ndeshjes, shënuesi i pikëve, delegati teknik, (kryegjyqtari dhe gjyqtari rezervë, nëse janë të caktuar).

Asnjë person tjetër nuk ka të drejtë të ulet në tavolinën e sekretarisë

2.9 Në të gjitha ndeshjet zyrtare apo miqësore klubi / shoqata pritëse në kalendar është përgjegjëse për sjelljen e publikut dhe tifozëve të saj para, gjatë dhe pas ndeshjes. Në të gjitha rastet kur spektatorët do të bëhen pengesë për zhvillimin normal të ndeshjeve atëhere do të vepohet sipas neneve të mëposhtëm 2.9.1 dhe 2.9.2.

2.9.1 Në pallatet e sportit apo sallat sportive të dënuara për çrregullime të publikut, FVK vendos për zhvillimin e ndeshjeve në këto pallate apo salla sportive, pa praninë e publikut.

Lejohen të aktivizohen në këtë rast: Skuadrat, trajnerët, përgjegjësit e klubeve, mjek apo masazhator, gjyqtarët e vëzhguesi, si dhe organet e Rendit Publik.

2.9.2 Në rast se çrregullimet do të vazhdojnë dhe do të ndikojnë direkt në rezultatin përfundimtar të ndeshjes, atëhere FVK vendos për pezullimin e ndeshjeve në këtë pallat, palestër apo sallës sportive dhe klubi vëndas gjobitet sipas akteve nën ligjore 500 €

2.10 Nuk lejohet që gjatë një ndeshje zyrtare skuadrat të ndryshojnë uniformën. Vetëm në rast kur një lojtar kërkon ndrrimin e saj për arësye të ndotjes apo dëmtimit të uniformës, vetëmkapiteni i lojës ka të drejtë të kërkojë autorizimin e gjyqtarëve për ndrrimin e saj, e cila duhet të jetë identike dhe me të njëjtin numër me të parën.

Ndrrimi i uniformës mund të bëhet në pushimet ndërmjet seteve apo kur lojtari është ndërruar me një lojtar tjetër. Zëvendësimi i uniformës bëhet vetëm në stolin e skuadrës ose në dhomën e zhveshjes.

2.10.1 Në rastet kur një lojtar vesh ndonjë bluzë tjetër nën fanellën e lojës apo nën pantallonat e shkurtra, të dallueshme nga uniforma sportive e skuadrës, kjo nuk ka nevojë për ndonjë autorizim të veçantë. Në rastet kur këto i mbajnë më shumë se një lojtar, atëhere ato duhet të kenë të një njëjtën ngjyrë.

2.11 Vetëm kapiteni i lojës ka të drejtë të komunikojë me gjyqtarët gjatë ndeshjes. Nuk lejohet që personat e tjerë të cilët janë në stolin e skuadrës të komunikojnë me gjyqtarët e lojës, gjatë ndeshjes.

2.11.1 Në rastet kur skuadra paraqitet pa trajner dhe mungon dhe zv/trajneri, asnjë person tjetër nuk ka të drejtë të drejtojë skuadrën nga stoli. Të drejtën për të kërkuar ndërprerje të rregullta të lojës e ka vetëm kapiteni i lojës.

2.11.2 Zv /trajneri mund të drejtojë skuadrën gjatë një ndeshjeje vetëm me kërkesën e kapitenit të skuadrës karshi gjyqtarit të parë në rastet kur:

- a. Trajneri i parë largohet vullnetarisht nga ndeshja.
- b. Trajneri i parë largohet për arsye të dënimit nga gjyqtarët.
- c. Trajneri i parë nuk paraqitet në ndeshje.

2.12 Për fitimin e veprimtarive kombëtare FVK vlerëson skuadrat, lojtarët e trajnerët me stimuj moralë e materialë si më poshtë:

- Kupa
- Medalje
- Diploma
- Vleftë nga 2.000.00€ per Kampionin e Superliges M/F dhe nga 1.000,00 per Nenkampionin e Superliges M/F, nga 500,00 per fituesit e Kupes se Kosoves M/F, sipas akteve nënligjore dhe vendimit te Bordit.

2.13 FVK organizon në bashkëpunim me Keshillin profesional ,Komisarin e garave Garave, me ekspert volejbollit strukturën prej 5 personash për shpalljen e lojtarëve më të dalluar në veprimtaritë zyrtare bazuar në statistikat e ndeshjeve dhe sjelljet e lojtarëve gjatë ndeshjeve, si dhe shpërblimin e tyre me stimuj moralë e materialë:

- Lojtarin më të mirë për meshkuj e femra
- Sulmuesin më të mirë për meshkuj e femra
- Organizatorin më të mirë për meshkuj e femra, liberon më të mirë për meshkuj e femra.

2.14 Në të gjitha veprimtaritë zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare vetëm Bordi i FVK-se ka të drejtën të përcaktojë tarifat dhe televizionin publik apo privat i cili do të transmetojë ndeshjet e volejbollit.

2.15. Kur një klubi të cilit i është deleguar organizimi i një veprimtarie zyrtare kombëtare apo ndërkombëtare nga FVK dhe klubi kërkon të drejtën për transmetimin në një televizion privat, Bordi i FVK-së mund ta miratojë atë vetëm pas kërkesës me shkrim dhe kushteve të paraqitura në kontratën ndërmjet klubit / shoqatës dhe televizionit privat respektiv.

2.16 Ndalohet kategorisht, në çdo rast dhe për asnjë arsye prekja, kërcënimi apo fyerja e gjyqtarëve nga ana e trajnerit dhe çdo anëtar i skuadrës gjatë zhvillimit të ndeshjes. Me KËRKESËN e gjyqtarit të I-rë, vetëm kapiteni i lojës ka të drejtë të komunikojë me gjyqtarin e I-rë.

2.17 Në të gjitha ndeshjet e organizuara nga FVK-ja, nuk do të ketë tajm aut teknik, por vetëm ata që kanë të drejtë trajneret e secilit ekip ti kerkojne, pra nga dy per cdo set.

KAPITULLI III

PJESMARRJA DHE AKTIVIZIMI I EKIPEVE DHE LOJTARËVE

NENI 3. Në veprimtaritë Kombëtare zyrtare të volejbollit marrin pjesë skuadrat e caktuara sipas strukturës organizative të miratuar nga Bordi i FVK, në përputhje me sezonin sportiv respektiv.

3.1 Sezoni sportiv përfshin gjithë veprimtaritë zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe të Kategorive , në përputhje me kalendarin sportiv vjetor të aktiviteteve, miratuar nga Bordi i FVK.

3.2 Në aktivitetet kombëtare e ndërkombëtare (zyrtare ose miqësore) aktivizohen trajnerë, sportistë e gjyqtarë me qëndrim të mirëmoral dhe të pa dënuar nga Komisioni Disiplinor apo ndonjë organ tjetër i FVK.

Për sportistin ose trajnerin që mund të përjashtohen nga klubi për arsye morale ose thyerje të disiplinës duhet të njoftohet zyrtarisht FVK. Sezoni sportiv i aktiviteteve zyrtare kombëtare të volejbollit fillon më 1 Shtator dhe mbaron më 31 Gusht të vitit pasardhës.

3.3 Klubet do të rregjistrojnë (federojnë) dhe licencojnë numër të pakufizuar lojtarësh.

3.4 Në të gjitha ndeshjet zyrtare do të aktivizohen jo më shumë se 12 lojtarë, përfshirë dhe lojtarin/lojtarët Libero. Dmth prej 8 deri në 12 lojtar mund të aktivizohen 1 ose 2 libero.

3.5 Në ndeshjet me sistem grumbullimi që janë të përcaktuara në "rregulloren e zhvillimit të aktiviteteve" do të aktivizohen vetëm lojtarët që janë të regjistruar në ditën e parë të aktivitetit. Nuk lejohet rregjistrimi apo ndryshimi i lojtarëve gjatë ditëve të zhvillimit të aktivitetit me sistem grumbullimi.

3.6 Lojtarët si meshkuj ashtu dhe femra nuk lejohen të regjistrohen dhe aktivizohen brenda një sezoni sportiv në dy Klube, si brenda vendit ashtu dhe jashtë vendit, më përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 4.7.5; - 4.7.6; të kësaj rregullore.

3.7 Në të gjitha veprimtaritë kombëtare brenda një sezoni sportiv, moshat lojtareve do të llogaritet vetëm me vitin pauses të lindjes, sipas federimit dhe liçensimit të sportistëve në fillim të sezonit sportiv.

3.7.1 Me skuadrat e të Rinjve dhe të Rejave marrin pjesë lojtarë deri në moshën 18 vjeç (U-18). Moshat e lojtarëve llogaritet vetëm me vitin pauses të vitit të lindjes. Lartësia e rrjetës për moshat U-18 meshkuj do të jetë 2.43m dhe U-18 femra 2.24m.

3.7.2 Me skuadrat e para të Rinjve dhe para të Rejave marrin pjesë lojtarë deri në moshën 16 vjeç(U-16). Moshë e lojtarëve llogaritet me vitin vijues pas atij të lindjes. . Lartësia e rrjetës për moshat U16 meshkuj do të jetë 2.35m dhe U-16 femra 2.24m

3.7.3 Me skuadrat e fëmijëve marrin pjesë djem e vajza me moshë deri 14 vjeç(U-14). Lartësia e rrjetës për djem do të jetë 2.24m dhe për vajza 2.15m.

3.7.4 Në minivolejbolll marrin pjesë fëmijë të moshës deri 12 vjeç(U-12). Lartësia e rrjetës si për meshkuj dhe për femra do të jetë 2.15m.

3.8 Çdo Klub për pjesëmarrjet në veprimtaritë zyrtare të volejbollit rregjistrohet në çdo sezon sportiv me anën e “Formularit të Rregjistrimit dhe Garancisë” lëshuar nga FVK. Formulari plotësuar duhet të dorëzohet për miratim në sekretariatin e FVK-es 30 ditë para fillimit të veprimtarisë së parë sportive. Rregjistrimi bëhet kundrejt pagesës së taksës së pjesëmarrjes për çdo ekip.

3.8.1 Çdo Klub / Shoqatë Sportive duhet të paguajë para fillimit të sezonit sportiv “taksën e detyrueshme të pjesëmarrjes për çdo ekip” në Bankën dhe Numrin e llogarisë së FVK.

3.8.2 Klubi i cili nuk do të paguajë “taksën e pjesëmarrjes” sipas ekipeve respektive, nuk mund të marrë pjesë në veprimtaritë zyrtare të sezonit sportiv.

3.8.3 “Taksa e pjesëmarrjes së ekipeve” është e pa rimbursueshme. Çdo Klubi i cili ka konfirmuar me shkrim pjesëmarrjen, ka likuiduar pagesën e taksës përkatëse dhe tërhiqet nga aktiviteti nuk mund t’ i kthehet shuma e paguar.

3.8.4 Klubi i cili do të ketë detyrime financiare të palikuiduara karshi FVK, nuk mund të rregjistrohet në sezonin e ri sportiv, pa likuiduar më parë detyrimet e prapambetura.

3.8.4.1 Të gjitha klubet që nuk dorëzojnë formularin në kohën e duhur do të gjobiten sipas akteve nën ligjore 100 € dhe mund të rregjistrohen në FVK 15 ditë para fillimit të aktivitetit të parë që hap sezonin sportiv. Pas përfundimit të këtij afati asnjë skuadër nuk ka të drejtë të rregjistrohet dhe të marrë pjesë në aktivitetet zyrtare kombëtare të sezonit sportiv. Skuadrat që nuk do të rregjistrohen në veprimtaritë kombëtare zyrtare nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare.

3.8.4.2 Gjatë veprimtarive kombëtare ose ndërkombëtare brënda të njëjtit sezon sportiv, nuk lejohet që një skuadër të ndryshojë emrin e saj me të cilën ajo është rregjistruar në fillim të sezonit sportiv.

3.8.4.3 Çdo skuadër përveç listës së federimit do të dërgojë në FVK liçensimin për çdo lojtar, trajner, zv/trajner, mjek, masazhator. Për çdo licencë të lojtarit do të paguhet vlefë e përcaktuar sipas akteve n/ligjore 5 €.

3.8.4.4 Periudha e miratimit të liçensave është 10 ditë para fillimit të veprimtarisë së parë sportive.

Të gjitha Klubet që nuk bëjnë licencimin në kohën e duhur, do të gjobiten sipas akteve nën ligjore 100 €

3.8.5 Të gjithë lojtarët vendor, meshkuj e femra të cilët nuk janë të rregjistruar në listat e federimit të skuadrave në fillim të sezonit sportiv, mund të rregjistrohen me anën e "Listës shtesë të federimit" , në çdo kohë, vetëm me skuadrën, që ata janë rregjistruar dhe aktivizuar në sezonin e fundit sportiv, si dhe në rast se lojtari plotëson kërkesat në përputhje me nenin 3.6 dhe 3.8.6 të kësaj rregullore.

3.8.6 Klubet vënë në dispozicion të FVK trajnerë, lojtarë, mjekë, fizioterapistë, masazhatorë, përkthyes që ajo cakton për ndeshje ndërkombëtare zyrtare dhe miqësore, në përputhje me strukturën dhe programin e FVK.

3.8.7 Mos paraqitja e personave të mësipërm sipas nenit 3.8.7 mund të justifikohet nga ana e tyre vetëm duke dërguar në FVK arësytet me shkrim. Pjesmarrja ose mos pjesmarrja e tyre vendoset nga FVK.

3.8.8 Gjatë zhvillimit të veprimtarive kombëtare ose ndërkombëtare, zyrtare ose miqësore si Kampionat Kombëtar, Kupa e Kosovës etj, për të Rritur e të Rritura të drejtën për t'u ulur në stolin e skuadrave e kanë vetëm trajnerë dhe zv/trajnerë të kategorisë së parë dhe të dytë sportive, mjeku ose masazher i skuadrës.

Të gjithë këta persona duhet të jenë njëkohësisht të federuar dhe të kenë licencën brenda të njëjtës skuadër.

Vetëm kapiteni i skuadrës mund të zëvendësojë trajnerin ose zv/trajnerin në rast të mungesës së tyre.

3.10 Nuk lejohet që në veprimtaritë për të Rritur, të Rritura, personat e regjistruar dhe licencuar si trajnerë dhe zv/trajnerë të skuadrave, të jenë njëkohësisht LOJTARË apo gjyqtar dhe të aktivizohen në veprimtaritë zyrtare të volejbollit brenda të njëjtit sezon sportiv. Gjithashtu lojtari i licencuar nuk mund të aktivizohet si refer. Poashtu referi i licencuar nuk mund të aktivizohet si trajner apo lojtar. Pra, vlenë koncepti: nje licence-nje veprimtari, per secilin pjestare te FVK-se.

3.10.1 Vetëm 2(lojtarë / lojtare) të moshës deri (U-18) LEJOHEN të luajnë në Kampionatin për të Rinj e të Reja (U18), pavarësisht se ata / ato mund të aktivizohen në Kampionatin Kombëtar për të Rritur dhe të Rritura, brenda të njëjtit sezon sportiv dhe brenda të njëjtit klub apo shoqatë sportive

3.10.2 Nuk lejohet ndryshimi i licencës nga trajner në lojtar apo anasjelltas, si dhe nga referi në lojtar apo trajner dhe anasjelltas brenda të njëjtes skuadër.

3.10.3 Fizioterapisti i skuadrës duhet të ketë diplomën përkatse nga "Institucionet shëndetsore" ose nga Institucione të njohura me ligj, që kanë kompetencën e lëshimit të dëshmive për fizioterapist.

3.11 Nuk lejoheq që lojtarët meshkuj dhe femra të aktivizohen me klubet Jashtë KOSOVËS, pa marrë më parë miratimin zyrtar të FVK dhe pa paguar taksën në FVK sipas akteve n / ligjore (500 €)

3.11.1 Në përputhje me nenin 3.11 lojtarët të cilët aktivizohen në veprimtaritë zyrtare jashtë Kosovës, NUK LEJOHEN të aktivizohen në veprimtaritë zyrtare të Kosovës brënda të njëjtit sezon sportiv.

3.13 Në të gjitha veprimtaritë kombëtare zyrtare, lojtarët e të gjitha skuadrave duhet të paraqiten me uniforma të rregullta dhe me numrat nga 1-24 si para ashtu dhe mbrapa fanellës sportive në përputhje me rregulloren Teknike.

3.13.1 Nuk lejoheq që në një ndeshje zyrtare të dyja skuadrat të kenë të njëjtën ngjyrë në uniformat e lojës. Skuadra udhëtuese) në kalendar është e detyruar të ketë uniformën e lojës me ngjyrë të ndryshme nga skuadra kundërshtare. Në rast të moszbatimit të këtij rregulli, skuadra musafire gjobitet 100 €

3.14 Të gjitha klubet të vendit tone që do të marrin pjesë në aktivitetet zyrtare të Kupave të Europës, korrespondencën me CEV (Konfederatën Europiane të Volejbollit) do t' a bëjnë nëpërmjet të FVK, ndërsa korrespondencën me skuadrën mike dhe gjyqtarët e caktuar për ndeshje do t' a bëjnë nëpërmjet Klubit të tyre, sipas udhëzimeve dhe rregullores të përcaktuar nga CEV në sistemin on-line, të caktuar për Klubet pjesmarrëse.

3.15. Të gjitha Klubet sportive që do të marrin pjesë në aktivitetet zyrtare të Kupave të Europës, duhet të konfirmojnë me shkrim në FVK garancinë e pjesëmarrjes dhe duhet të ngurtësojnë në një Bankë në emër të FVK shumën prej 7000(shtatë mijë) euro si garanci financiare, para se ato të japin konfirmimin për pjesëmarrjen në aktivitetet për Kupat e Europës. Shuma e mësipërme do të jetë e ngurtësuar deri në përfundimin e pjesëmarrjes së ekipit në aktivitetin ku ai merr pjesë.

3.15.1 FVK ka të drejtën të pezullojë nga aktivitetet Kombëtare Zyrtare çdo Klub e cila ka detyrime Financiare të palikuiduara karshi CEV, për mos respektimin e rregullores ndërkombëtare në pjesëmarrjet në Kupat e Europës.

3.15.3 Lejoheq që një skuadër e cila merr pjesë në aktivitetet zyrtare ndërkombëtare për Kupat e Europës, të zhvillojë dy ndeshjet në fushën kundërshtare, ose si vendas.

3.16 Për zhvillimin e veprimtarive ndërkombëtare me sistem grumbullimi do të përgjigjet klubi te cilit i është caktuar organizimi i veprimtarisë, me kusht që ai të plotësojë pikat e rregulloreve (teknike dhe të brëndëshme), për zhvillimin normal të veprimtarisë, duke marrë përsipër të gjitha detyrimet financiare dhe organizative për zhvillimin normal të veprimtarisë, në përputhje me standartet e kërkuara nga FIVB, CEV dhe FVK.

3.16.1 Çdo Klub duhet të dërgojë me shkrim në FVK kërkesën për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë ndërkombëtare në përputhje me pikën 3.17, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të sezonit sportiv.

3.17 Në veprimtaritë zyrtare ndërkombëtare që do të zhvillohen në vendin tonë, Klubi pritës duhet të likujdojë para zhvillimit të ndeshjes shpërblimet për grupin e gjyqtarëve të cilat përmbledhin:

- a. Shpenzime për shpërblimin e gjyqtarit I-rë, gjyqtarit II-të dhe delegatit teknik në përputhje me rregulloren ndërkombëtare të aktiviteteve të CEV.
- b. Shpenzime për udhëtimin, hotelin, ushqimin për gjyqtarët dhe delegatin teknik të huaj.
- c. Shpenzime për shpërblimin e sekretarit, anësorëve dhe pikëshënuesit vendorë.

3.18 Në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare shpërblimi për sekretarinë dhe gjyqtarët anësorë do të jetë sipas tabelës së shpërblimeve miratuar nga Bordi dhe në përputhje me kategorinë si gjyqtar.

3.19 Në veprimtaritë zyrtare Kombëtare dhe Ndërkombëtare Klubi (shoqata) sportive pritës duhet të njoftojë mbi rezultatin e ndeshjes në FVK dhe CEV, menjëherë pas përfundimit të saj.

3.20 Çdo shoqatë sportive apo skuadër private që do të marrë pjesë në veprimtaritë zyrtare kombëtare të volejbollit, duhet të paraqesë në FVK dokumentacionin e plotë të regjistrimit të saj nga Drejtorati respektiv. për t'u regjistruar si antare dhe pjesëmarrëse nëaktivitetet zyrtare të FVK.

3.20.1 Pjesëmarrja e këtyre skuadrave në veprimtaritë zyrtare kombëtare do të fillojë nga kategoria më e ulët në një kategori më të lartë.

3.21 Nuk lejohet që gjatë veprimtarive zyrtare kombëtare brënda të njëjtit sezon sportiv, 2 skuadra të të njëjtit qytet (komunë) të përfaqsohen me të njëjtin emër, si brënda të njëjtës kategori dhe gjini, ashtu dhe në kategori e gjini tjetër.

3.22 Të gjitha ekipet, lojtarët apo trajnerët të cilët kanë detyrime karshi FVK-es, nuk do të regjistrohen, licencohen dhe aktivizohen, pa shlyer më parë detyrimet e tyre. Në detyrimet karshi FVK përfshihen dhe:

- a. Mungesa e dokumentacionit të rregullt fillestar (lista e regjistrimit, federimit, licencimet)
- b. Mos likuidimi i taksave të detyrueshme brënda afatit të parashikuar karshi FVK, Detyrime të palikujduara karshi FVK janë dhe të gjitha detyrimet e palikujduara të sezonit sportiv të mëparshëm.
- c. Mos dorëzimi i bazës materiale të ekipeve Kombëtare

KAPITULLI IV

TRANSFERIMI I LOJTARËVE (M/F) BRENDA VENDIT

NENI 4

Të gjithë lojtarët meshkuj dhe femra me pasaportë Kosovare kanë të drejtë të transferohen (lëvizin) nga një klub në një tjetër klub, si brenda vendit ashtu dhe jashtë vendit, sipas procedurave të parashikuara nga FVK.

4.1 FVK legalizon transferimin e lojtarëve meshkuj dhe femra brenda vendit në përputhje me tri pikat e mëposhtme:

- a. Çdo skuadër ka të drejtë të marrë dhe të aktivizojë për një sezon sportiv lojtarë vendor (numri i pakufizuar).
- b. Për lojtarë meshkuj dhe femra të cilët nuk kanë kontratë individuale të noterizuar me ndonjë klub.
- c. Për lojtarë meshkuj dhe femra të cilët kanë kontratë individuale me një klub të noterizuar dhe të depozituar në FVK.

4.2 Transferimi për të gjithë lojtarët meshkuj dhe femra të cilët nuk do të kenë kontratë individuale të noterizuar me klubin të depozituar në FVK, do të jetë pa asnjë detyrim financiar. Klubi që merr lojtarin, paguan vetëm taksën në FVK prej 50€, përçdo lojtar.

4.3 Kontratat për transferimin e lojtarëve brenda vendit, bëhen nga mosha 18 – 30 vjeç për meshkuj dhe nga mosha 18-26 për femra. Klubet janë të detyruara të bëjnë kontrata individuale ligjore me sportistët e tyre, që marrin pjesë në aktivitetet zyrtare të FVK.

4.3.1 Në përfundim të çdo sezoni sportiv të gjithë lojtarët meshkuj dhe femra të moshave 14 – 18 vjeç dhe 18 – 30 vjeç, të cilët nuk do të kenë kontrata të noterizuara dhe të depozituara në FVK , ose te vertetuara nga FVK me klubet respektive të tyre, kanë të drejtë të transferohen brenda vendit, me kontratë duke përdorur " Çertifikatën e transferimit" sipas procedurave të parashikuara në këtë rregullore.

4.3.3 Në rast se klubi do të ketë kontratë të noterizuar ose te vertetuar ne FVK me lojtarin/en të depozituar në FVK, atëhere asnjë transferim nuk mund të legalizohet nga FVK, pa miratimin zyrtar të Klubit që disponon kontratën e lojtarit / es duke respektuar kushtet sipas kontratës respektive të lojtarit/es.

4.4 Kontratat për transferimin (lëvizjen) e lojtarëve brenda vendit, për moshat 14 – 18 vjeç do të nënshkruhen nga prindi apo kujdestari i njohur me ligj për këtë qëllim. Transferimi i këtyre lojtarëve bëhet pa asnjë detyrim financiar

4.4.2 Moshë e lojtarëve përcaktohet vetëm sipas vitit pauses te vitit te lindjes.

4.5 Transferimi i lojtarit(es) me moshë nën 18 vjeç mund të bëhet me „Leje Kalimi “, vetëm atëhere kur dy Klube bien dakort dhe zyrtarisht(me shkrim) dërgojnë në FVK formularin zyrtar të plotësuar prej tyre, për lëvizjen e lojtarit/es.

4.6 Transferimi i lojtarëve brënda vëndit, nga njëri klub në një klub tjetër bëhet vetëm me anë të "Çertifikatës së transferimit" (formati zyrtar) lëshuar nga FVK.

4.6.1 Proçedura e transferimit fillon nga klubi (shoqata) sportive që do të marrë lojtarin. Pas plotësimit të „Çertifikatës së Transferimit ” nga ana e lojtarit, zyrtarizimit (firmë + vulë) nga klubi (shoqata) sportive që merr lojtarin dhe pagesës së taksës së detyrueshme në FVK prej 50€. FVK lejon në këtë rast të drejtën e transferimit të sportistit.

4.6.2 "Çertifikata e transferimit" duhet të plotësohet në 3 ose 4 kopje:

1 kopje (origjinali) në FVK.

1 kopje i ipet lojtari.

1 kopje klubit që merr lojtarin.

1 kopje klubi që jep lojtarin (kur lojtari ka kontratë me klubin).

4.7 Kontratat për transferimin e lojtarëve brenda vëndit bëhen vetëm në dy periudha:

a. Periudha e I-rë: Nga 15 Gusht – 31Gusht ora 23.59

b. Periudha e II-të: Nga 15 Janar - 31 Janar ora 23.59

(Periudha e II-të do të zbatohet vetëm për ata lojtarët vendor që nuk janë federuar, nuk kanë marrë licencë dhe nuk janë aktivizuar në asnjë skuadër të Kosovës, brenda të njëjtit sezon sportiv).

4.7.1 Një lojtar konsiderohet i transferuar kur largohet nga një klub në një klub tjetër. Çdo lojtar nuk mund të bëjë më shumë se 1(një) kontratë brenda sezonit sportiv.

4.7.2 Lojtari i transferuar nuk ka të drejtë të ndryshojë klubin brenda të njëjtit sezon sportiv.

4.7.4 Pas përfundimit të procedurave të transferimit, FVK nuk mban përgjegjësi për detyrimet e sportistit ndaj klubit /shoqatës sportive, si dhe për detyrimet ndërmjet dy klubeve.

4.7.5 Në fillim të sezonit klubet e të gjitha niveleve për meshkuj dhe femra që nuk do të rregjistrohen dhe licencohen për pjesëmarrjen e tyre në veprimtaritë zyrtare të FVK, të gjithë lojtarët meshkuj dhe femra të këtyre skuadrave janë të lirë të rregjistrohen, federohen dhe aktivizohen me cilën skuadër që ata dëshirojnë.

4.7.6 Gjatë sezonit sportiv në vazhdim në rast se një ose më shumë skuadra ndërpresin pjesëmarrjen e tyre nga veprimtaritë zyrtare të para 31Dhjetorit, atëherë të gjithë lojtarët meshkuj dhe femra të këtyre skuadrave janë të lirë të rregjistrohen dhe licencohen me çdo skuadër që ata preferojnë vetëm në periudhën 1-31 janar

4.7.7 Në rast se një ose më shumë skuadra ndërpresin pjesëmarrjen e tyre nga veprimtaritë zyrtare të FVK gjatë sezonit sportiv në vazhdim (pjesa pranverore) ,atëherë të gjithë lojtarët meshkuj dhe femra të këtyre skuadrave janë të lirë, por të drejtën për t' u rregjistruar, licencuar e aktivizuar me skuadrën që ata preferojnë e kanë vetëm në sezonin pasardhës.

HUAZIMI I LOJTARËVE BRENDA VENDIT

4.8.8 Vetëm brenda fazës së I-rë të Kampionatit Kombëtar në vazhdim për të Rritur dhe të Rritura, çdo klub mund të huazojë jo më shumë se 3(tre) lojtarë/re nga klubet tjera brenda vendit. Pas përfundimit të fazës së I-rë të Kampionatit në vazhdim, nuk lejohet huazimi i lojtarëve.

Huazimi i lojtareve mbrenda kampionati kombetar lejohet:

Pas afatit kalimtar deri para filimit të gjiros së parë dhe i njëjti ka të drejtë kthimi në afatin 1 janar-31 janar

Lojtari mund të huazohet pas fillimit të kampionatit por pa të drejtën e kthimit në klubin amë deri në përfundim të sezonit pranveror

4.8.1 Bordi FVK lejon huazimin e lojtarit vetëm pas aprovimit zyrtar me shkrim nga të dy Klubeve të interesuara.

4.8.2 Lojtari i huazuar mund të kthehet brenda të njëjtit sezon sportiv në klubin , që ai është regjistruar në fillim të sezonit sportiv, vetëm në periudhën 1 janar – 31 Janar të të njëjtit sezonit sportiv.

TRANSFERIMI I LOJTARËVE TË HUAJ (m+f) NË KOSOVË

4.9 Çdo skuadër ka të drejtë të marrë dhe të aktivizojë lojtarë të huaj (numri i pakufizuar) me në fushën e lojës, do të jenë vetëm 2 lojtarë të huaj. Raporti i lojtarëve në fushën e lojës (ndeshje) për të gjitha skuadrat pjesëmarrëse në veprimtaritë zyrtare Kombëtare, do të jetë 2 lojtarë të huaj dhe kontratë 1 vjeçare (për një sezon sportiv) ose me kontratë 6 mujore, me kushtin që gjithmonë 4 lojtarë vendorë (me shtetesi Kosovare).

4.9.1 Kontratat për transferimin e lojtarëve të huaj bëhen vetëm në periudhën:

01 shtator - 31 janar ora 23:59

(pas përfundimit të çdo sezoni sportiv dhe brenda sezonit të ri . Brenda këtyre afateve duhet të përfundojë e gjithë procedura e transferimit on-line me FIVB dhe lojtari duhet të ketë Çertifikatën Ndërkombëtare të Transferimit (ITC) të lëshuar nga i vetmi organ kompetent, që është FIVB.

4.9.1.1 Në rast se një klub apo shoqatë sportive aktivizon një lojtar të huaj pa përfunduar procedurën e marrjes së Çertifikatës Ndërkombëtare të Transferimit (ITC) gjohet sipas rregullores së FIVB me 30.000 (tridhjetmijë) euro.

4.9.2 Transferimi në Kosovë i lojtarëve me pasaportë të huaj dhe anëtarë të një Federate tjetër Volejboli bëhet vetëm me anë të procedurës on line përcaktuar nga FIVB.

4.9.2.1 Vetëm pas përfundimit të procedurës së regjistrimit on-line në FIVB, marrjes së çertifikatës ndërkombëtare të transferimit (ITC) dhe pagesës së taksës në FVK prej 200, FVK jep licensën e aktivizimit të lojtarit të huaj. Pas marrjes së licensës lojtari duhet të veprojë në përputhje me nenin 3.6 të kësaj rregullore.

4.9.2.2 Jashtë periudhave të përcaktuara në këtë rregullore FVK nuk kryen veprime për transferimin e lojtarëve.

4.9.3 Për aktivizimin e lojtarit të huaj në aktivitetet zyrtare ndërkombëtare, klubi që merr lojtarin duhet të paguajë në CEV taksën e detyrueshme sipas rregullores së CEV-it. Pa këtë pagesë lojtari nuk mund të aktivizohet në aktivitetet zyrtare ndërkombëtare.

4.9.4 Transferimi në Kosovë i lojtarëve me pasaportë Amerikane dhe që është aktivizuar vetëm në Kampionatet e Universiteteve në Amerikë bëhet vetëm me anë të "Çertifikatë Transferimi për Lojtarë të Huaj" (formati zyrtar i FVK).

4.9.5 Lojtari me pasaportë Amerikane duhet të paraqesë në FVK:

1. Deklaratë të noterizuar nga Universiteti në Amerikë që është i lirë të aktivizohet dhe nuk është antar i Federatës Amerikane të Volejbollit.
2. Pasaporta e Lojtarit
3. Deklarata personale e lojtarit që shpreh dëshirën për t' u aktivizuar në Kosovë dhe që nuk është anëtar i ndonjë Federate tjetër.

4.9.5.1 Vetëm pas verifikimit të dokumentacionit dhe pagesës së taksës në FVK prej 200 €, FVK jep liçensën e aktivizimit të lojtarit të huaj. Pas marrjes së liçensës lojtari duhet të veprojë në përputhje me nenin 3.6 të kësaj rregullore.

KAPITULLI V

TRANSFERIMI I LOJTARËVE VENDOR JASHTË SHETIT

5. Çdo lojtar ka të drejtën të aktivizohet në një klub sportiv jashtë shtetit me kontratë, sipas procedurave të përcaktuara nga FIVB.

5.1 Transferimi i lojtarëve Kosovar jashtë shtetit bëhet me anë të procedurës online e përcaktuar nga FIVB. FVK bën rregjistrimin e lojtarit në FIVB, pasi ka përfunduar marrëveshja me klubet respektive dhe janë kryer detyrimet karshi Klubit dhe FVK. Për të marrë Çertifikatën Ndërkombëtare të Transferimit (ITC), Klubi që merr lojtarin ose vetë lojtari duhet të paguajë në sekretariatit e FVK taksën sipas tarifës të përcaktuar nga CEV, për çdo sezon sportiv dhe për çdo lojtar.

Pa paguar taksën e detyrueshme, sekretariati i FVK nuk bën rregjistrimin e lojtarit në FIVB për transferimin ndërkombëtar.

KAPITULLI VI

KLASIFIKIMI

NENI 6. Klasifikimi i skuadrave në përfundim të veprimtarive zyrtare kombëtare bëhet në bazë të renditjes së tyre, sipas strukturës së veprimtarive të miratuar nga Bordi i FVK-se.

Të gjitha klubet duhet të njihen 4 muaj para fillimit të sezonit sportiv për mënyrën e organizimit dhe klasifikimit në veprimtaritë zyrtare kombëtare.

- Për çdo ndeshje të fituar me rezultatin 3-0 dhe 3-1: skuadra merr 3 pikë.
- Për çdo ndeshje të fituar me rezultatin 3-2: skuadra merr 2 pikë.
- Për çdo ndeshje të humbur me rezultatin 2-3: skuadra merr 1 pikë.
- Për çdo ndeshje të humbur 0-3 dhe 1-3: skuadra merr 0 pikë.

Në të gjitha ndeshjet me sistem grumbullimi:

- për çdo ndeshje të fituar skuadra merr 2 pikë •për çdo ndeshje të humbur skuadra merr 1 pikë.

6.1 Në rastet kur dy ose më shumë skuadra rezultojnë me pikë të barabarta, atëherë për klasifikimin e tyre do të vendoset sipas renditjes së mëposhtme alfabetike:

- a. Mbi bazën e numrit më të madh të ndeshjeve të fituara. Fiton skuadra që ka numrin më të madh të ndeshjeve të fituara.
- b. Në rast se barazimi vazhdon atëherë do të vendoset mbi bazën e koeficientit më të madh që del nga raporti i seteve të fituara me ato të humbura, të grumbulluara në të gjitha ndeshjet. P.sh:

Skuadra A ka fituar 12 sete dhe ka humbur 8 sete
Skuadra B ka fituar 14 sete dhe ka humbur 10 sete

Koeficienti i skuadrës A është: $12 : 8 = 1.5$

Koeficienti i skuadrës B është: $14 : 10 = 1.4$

Fiton skuadra me koeficientin më të madh.

- c. Në rast se barazimi vazhdon atëherë do të vendoset mbi bazën e koeficientit më të madh që del nga raporti i pikëve të fituara me ato të humbura, të grumbulluara në të gjitha ndeshjet. Fiton skuadra me koeficientin më të madh.
- d. Në rast se barazimi vazhdon atëherë fituesja përcaktohet mbi bazën e rezultateve të ndeshjeve direkte ndërmjet skuadrave me pikë të barabarta.

KAPITULLI VII

DËNIMET

NENI 7. FVK për të gjitha rastet e shkeljes së rregulloreve të volejbollit aplikon dënime të ndryshme për skuadra dhe individë pjesmarrës në veprimtaritë zyrtare.

7.1 Për mos paraqitje në një ndeshje të veprimtarisë zyrtare skuadra merr 0 pikë dhe gjobitet sipas akteve nën ligjore 150 €

7.2 Në rastet kur ndeshja humbet për arsye të shkeljes së rregulloreve, skuadra që e ka shkelur atë merr 0 pikë, rezultati përfundimtar i seteve do të jetë 0-3, rezultati i pikëve 0-75 dhe do të gjobitet sipas akteve nën ligjore 200 €

7.3 Një skuadër që humbet dy ndeshje me 0 pikë për mosparaqitje gjatë veprimtarisë zyrtare Kombëtare, i hiqen të gjitha pikët në ndeshjet e luajtura dhe skuadra diskualifikohet nga Veprimtaria Zyrtare, si dhe gjobitet me 300€

7.4 Në rast se një skuadër nuk paraqitet në një nga ndeshjet e fazave "play-off" dhe "playout", ajo skualifikohet nga Kampionati Kombëtar dhe gjobitet sipas akteve nën ligjore (500€)

7.4.1 Klubi i cili diskualifikohet sipas nenit 6.4, përjashtohet për 2(dy) sezone sportive rradhazi nga aktivitetet zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare.

7.4.2 Në rast se një lojtar aktivizohet në veprimtaritë zyrtare Kombëtare në kundërshtim me nenin 4.9 të kësaj rregullore, skuadra me të cilën ai aktivizohet, gjatë ndeshjes ekipit i merren piket të cilat janë fituar prej momentit të aktivizimit të tij, si dhe trajnerit i jepet karton I kuq nga referi i pare, ndersa ekipi denohet me 100 euro.

7.4.3 Në përputhje me nenin 7.4.2 pas nënshkrimit të procesit loja të regjistrohet sipas rezultatit të arritur.

7.5 Në të gjitha veprimtaritë zyrtare me sistem grumbullimi Kupa e Kosoves, Kupa e FVK skuadra që nuk paraqitet në ndeshjen e parë, përjashtohet nga veprimtaria dhe gjobitet sipas akteve (150€)

7.6 Për çdo karton të kuq që merr lojtari ose ndonjë anëtar i skuadrës gjobitet sipas akteve nën ligjore " (20 €)

7.7 Për çdo karton të kuq që merr trajneri, zëvendës trajneri ose masazheri i skuadrës gjobitet sipas akteve nën ligjore "(50 €)

7.9.1 Kur një lojtar-e , trajner, zv/trajner ose masazher merr njëkohësisht karton të verdhë + karton të kuq bashkë (në një dorë) ose ndaras duart dënohet sipas rregullores Teknike dhe gjobitet sipas akteve nën ligjore 50 €” .

7.9.4 Kur një lojtar merr njëkohësisht karton të verdhë + karton të kuq bashkë (të ndara në dy duart) dënohet sipas rregullores Teknike, gjobitet sipas akteve nën ligjore “70 €” dhe nuk aktivizohet në ndeshjen pasardhëse.

7.9.5 Kur një trajner, zv/trajner apo masazher merr njëkohësisht karton të verdhë + karton të kuq bashkë (të ndara në dy duart) dënohet sipas rregullores Teknike, gjobitet sipas akteve nën ligjore “100 € dhe nuk aktivizohet në ndeshjen pasardhëse.

7.9.7Për çdo dënim të dhënë, lojtari, trajneri ose çdo antar i skuadrës që dënohet, duhet ti merret licenca nga ana e vëzhguesit apo referit të pare dhe të dorzohet ne FVK.

7.9.8 Çdo lojtar, trajner ose ndonjë anëtar i skuadrës nuk mund të aktivizohet në ndeshjen pasardhëse pa shlyer detyrimin financiar në llogarinë e FVK sipas detyrimit përkatës dhe të rrimarrë licencën e tij.

7.9.8.1Dënimet do të zbatohen për të gjithë personat e licencuar dhe të rregjistruar në ndeshjet zyrtare.

7.9.8.2Pagesa e dënimeve bëhet individualisht nga çdo person që ndëshkohet me to.

7.9.8.3 Dënimet për lojtarët, trajnerët, zv/trajnerët apo antarët e licencuar të skuadrave pjesmarrëse në ndeshjet zyrtare mund të jepen dhe pas përfundimit të ndeshjes, në rast të veprimeve të ndryshme anti sportive, në kundërshtim me rregulloret e lojës së voleybollit.

7.9.8.4 Dënimet që mund të marrin Klubet, lojtarët, trajnerët, zv/trajnerët, zyrtarë, gjyqtarë apo antarë të tjerë të licencuar në FVK në fund të sezonit sportiv do të aplikohen në fillim të sezonit të ri sportiv.

7.9.8.5.Asnjë subjekt i dënuar nuk mund të marrë pjesë në aktivitetet zyrtare kombëtare, deri sa të shlyejë dënimin e marrë nga organet respektive të FVK.

7.9.8.6Të gjithë trajnerët, zv.trajnerët, mjekët, masazhatorët apo përfaqësues të klubeve dhe shoqatave sportive, që do të veprojnë në kundërshtim me nenin 2.16 të kësaj rregullore do të dënohen nga Komisioni Disiplinor me pezullim të përkohshëm apo të përhershëm nga aktivitetet zyrtare të voleybollit dhe do të gjobiten me vleftën nga 50€ deri në 300 €.

KAPITULLI VIII

REKLAMIMI I NDESHJES

8. Reklamimet do të merren parasysh vetëm kur ka shkelje të rregullores Teknike dhe asaj të Brëndëshme të FVK.

8.1 Kur një skuadër reklamon një ndeshje duhet të njoftojë menjëherë pas mbarimit të saj gjyqtarin e I-rë dhe reklamimin me shkrim duhet t'ja paraqesë gjyqtarit të I-rë brënda 30 minutave nga pëfundimi i ndeshjes.

8.1.1 Për gabimet në protokollin e ndeshjes nuk pranohet asnjë reklamim, por do të vendoset sipas rregullores Teknike, që për çdo gabim duhet të ndreqet menjëherë, që në momentin e konstatimit.

8.1.2 Reklamimin e bën vetëm kapiteni i skuadrës. Dokumentin e firmosur nga kapiteni i skuadrës, gjyqtari i I-rë ja bashkangjit protokollit të ndeshjes.

8.1.3 Për reklamimin, gjyqtari i I-rë vë në dijeni menjëherë dhe kapitenin e skuadrës kundërshtare. Reklamimi në çdo rast bëhet kundrejt pagesës sipas akteve nën ligjore (50€). Brënda 48 orëve nga dita e parë e punës pas ndeshjes ekipi që ka bërë reklamimin duhet të kryejë pagesën në numrin e llogarisë së FVK.

8.1.4 Në rast të mos kryerjes së kësaj pagese kërkesa për reklamim nuk pranohet.

KAPITULLI VIII

GJYQTARËT DHE DELEGATI TEKNIK (VËZHGUESI)

NENI 9. Shoqata e Gjyqtarëve vënë në dispozicion të FVK-së gjyqtarë të kategorisë së I-rë, II-të dhe III-të për veprimtaritë zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare, për çdo sezon sportiv.

9.1 1 Gjyqtarët e ndeshjeve të voleybollit janë pjesë e strukturës së të FVK.

9.1.1 1 Gjyqtarët e voleybollit janë persona individualë të cilët në përputhje me kërkesat e kësaj rregullore mund të kërkojnë aderimin e tyre si gjyqtarë në FVK.

9.1.2 2 Pranimi për të qenë gjyqtar voleybolli bëhet mbi bazën e dëshirës dhe kërkesës me shkrim të çdo individi, drejtuar komisionit të Shoqatës së Gjyqtarëve, bazuar në kriteret e kësaj rregullore.

9.1.3 3 Të gjithë personat që do të fitojnë të drejtën për të qenë gjyqtarë të ndeshjeve të voleybollit, detyrimisht duhet t' i nënshtrohen kurseve të kualifikimit dhe rikualifikimit, në teori dhe praktikë, për të drejtuar ndeshjet e voleybollit. Pas miratimit nga Bordi të gjithë gjyqtarët duhet të licencohen në FVK sipas tarifës së përcaktuar në këtë rregullore, për çdo sezon sportiv.

9.1.4. Lista e federimit të Gjyqtarëve plotësohet sipas kërkesave të FVK, nga Shoqata e Gjyqtarëve. nënshkruhet nga çdo gjyqtar dhe vëzhgues

9.1.5. Lista e federimit të gjyqtarëve dërgohet në FVK 20 ditë para fillimit të veprimtarisë së parë zyrtare të sezonit sportiv

9.1.6Lista e federimit të gjyqtarëve dhe vëzhguesve miratohet nga Bordi, si dhe publikohet nga FVK

9.2 Për drejtimin e ndeshjeve zyrtare kombëtare e ndërkombëtare gjyqtarët propozohen nga Shoqata e Gjyqtarëve dhe miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm i FVK.

9.3 Në rast se në një ndeshje mungojnë gjyqtarët e caktuar veprohet si më poshtë:

- a. Kur mungon gjyqtari i I atë e zëvendëson gjyqtari i II dhe gjyqtari i II caktohet nga vendi pritës, i cili duhet të jetë i federuar dhe të ketë liçencë.
- b. Kur mungon gjyqtari i II atë e zëvendëson një gjyqtar tjetër i vendit pritës, i cili duhet të jetë i federuar dhe të ketë liçencë.
- c. Kur mungojnë të dy gjyqtarët atëhere ndeshjen do t'a drejtojnë 2 gjyqtarë të vendit pritës të cilët duhet të jenë të federuar dhe të kenë liçencë.
- d. Zbatimi i pikave a,b,c do të bëhet 30 minuta pas orës së caktuar për fillimin e ndeshjes.

9.4 Në veprimtaritë me sistem grumbullimi Kryegjyqtari dhe gjyqtarët që drejtojnë ndeshjet caktohen nga Komisioni i garave (Komesari i garave) dhe miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm i FVK

Caktimi i gjyqtarëve për drejtimin e ndeshjeve bëhet nga Kryegjyqtari ose Komesari i garave

9.5 FVK cakton vëzhgues në veprimtaritë kombëtare, i cili ushtron të drejtën e kontrollit për zbatimin e rregulloreve dhe udhëzimeve të tyre.

9.5.1 Bordi i FVK-se miraton për çdo sezon sportiv listën emërore dhe numrin e vëzhguesve që do të aktivizohen.

9.5.2. Kriteret për të qenë Vëzhgues i FVK:

1. Të ketë qenë lojtar ose trajner me ekipet Kombëtare.
2. Të njohë shumë mirë mbajtjen e statistikave të lojës dhe të bëjë evidentimin e tyre.
3. Të njohë procedurën e lojës.
4. Të mos jetë anëtar i ndonjë klubi.
5. Të mos ketë konflikt interesash me të qenit vëzhgues i FVK-së.
6. Për aktivizimin në aktivitetet ndërkombëtare duhet të njohë shumë mirë gjuhën Angleze.

9.5.3 Vëzhguesit mund të jenë dhe antarët e Komisionit Tekniko – Arbitral, i miratuar nga Bordi i FVK-se.

9.5.4 Vëzhguesi nuk mund të jetë një person që në të njëjtën kohë është trajner aktiv, gjyqtar aktiv dhe lojtar aktiv.

9.5. Gjyqtari i I-rë dhe vëzhguesi i ndeshjes, në rast të mos paraqitjes së njërës skuadër në orarin e caktuar kanë të drejtë:

Të shtyjnë orarin e fillimit të ndeshjes vetëm 30 minuta nga orari i caktuar në pritje të skuadrës tjetër duke qënë të pranishëm në fushën e lojës.

Në rast se njëra skuadër nuk paraqitet në fushën e lojës brënda këtyre 30 minutave ndeshja fitohet aforfe 3-0 dhe 75-0 nga skuadra e pranishme në fushë dhe skuadra e cila nuk u paraqit gjobitet me 150 €

9.6 Kryegjyqtari 1 orë pas përfundimit të ndeshjes njofton me telefon, me fax ose telegram mbi rezultatin e ndeshjes në FVK.

9.6.1 Kryegjyqtari jo më vonë se 24 orë pas përfundimit të ndeshjes dërgon në FVK raportin mbi zhvillimin e veprimtarisë, klasifikimin, protokollet, reklamimet, aktivizimin e lojtarëve, trajnerëve dhe gjyqtarëve.

9.7 Në veprimtaritë zyrtare ku nuk është caktuar kryegjyqtar, gjyqtari i parë ose vëzhguesi i ndeshjes do të ndjekin të njëjtën procedurë si në pikat 8.6 dhe 8.6.1.

9.8 Protokoli i ndeshjes duhet të plotësohet me kujdes dhe të jetë i lexueshëm duke respektuar të gjitha kërkesat e rregullores Teknike.

Ai plotësohet në 3 kopje nga të cilat origjinali dërgohet në FVK, kopja e dytë skuadrës fituese dhe kopja e tretë skuadrës humbëse.

9.9 Gjyqtarët duhet të jenë të gatshëm në fushën e lojës, 40 minuta para fillimit të ndeshjes.

9.9.1 Gjyqtarët nuk duhet të lejojnë që brënda fushës së lojës të futen persona të tepërt, në kundërshtim me ato që përcakton rregullorja Teknike e Lojës.

9.9.2 Klubet sportive nuk kanë të drejtë për asnjë arësye dhe në asnjë rast të bëjnë zëvendësimin e gjyqtarëve të caktuar nga Komisioni Teniko- Arbitral dhe të miratuar nga FVK më parë. Ata mund të bëjnë propozime dhe të presin miratimin e tyre nga FVK.

9.9.4 Gjyqtarët gjatë ndeshjeve janë gjatë drejtimit të ndeshjeve janë persona zyrtarë publikë dhe si të tillë ata mbrohen nga "Ligji për Sportin" në ushtrimin e detyrës së tyre. Ata për drejtimin e ndeshjes mbështeten në rregulloren Teknike, rregulloren e Brëndëshme, si dhe në të gjitha ndryshimet e bëra dhe të dërguara zyrtarisht me shkrim nga FVK.

9.9.5 E drejta për të drejtuar ndeshjet në veprimtaritë zyrtare kombëtare mund të pezullohet për gjyqtarë të veçantë në këto raste:

- a. Kur Gjyqtari nuk rregjistrohet në FVK 15 ditë para fillimit të veprimtarisë së parë zyrtare kombëtare. Gjyqtari në këtë rast pezullohet për një fazë të sezonit sportiv dhe gjobitet sipas akteve nën ligjore (50€).
 - b. Kur gjyqtari paraqitet me vonesë në ndeshje dënohet për 2 ndeshje pasardhëse.
 - c. Kur nuk paraqitet në ndeshjen zyrtare i caktuar nga FVK dënohet 4 ndeshje dhe 100 euro. Në rast përsëritje dënohet për 1 fazë dhe gjobitet sipas akteve nën ligjore (200€).
 - d. Kur pa arsye dhe pa vënë në dijeni Komisionin Tekniko- Arbitral, gjyqtari largohet për një periudhë prej 6 muajsh atëherë ai automatikisht nuk gëzon të drejtën e aktivizimit në veprimtaritë zyrtare kombëtare të sezonit sportiv. Gjobitet sipas akteve nën ligjore 350 €.
 - e. Kur pa arsye mungon 1 sezon sportiv ai/ajo skualifikohet për 2 vjet dhe ulet 2(dy) Kategori si Gjyqtar
 - f. f. Kur për drejtim të dobët, i cili ndikon drejtpërsëdrejti në rezultatin përfundimtar të ndeshjes, gjyqtari pezullohet 5 ndeshje nga veprimtaria zyrtare kombëtare.
 - g. Kur vepron në mënyrë të qëllimshme, në kundërshtim me Kodin e Etikës, duke prishur imazhin e FVK e cila mund të sjellë vonesë në fillimin e ndeshjes apo anulimit të saj, përjashtohet nga veprimtaritë zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare, për një periudhë nga 1 deri 2 vjet, ulet 2(dy) kategori si gjyqtar dhe dënohet me gjobë deri 500 €.
 - h. Kur para ose pas ndeshjes ul figurën e tij morale pezullohet deri 2 vjet nga veprimtaritë zyrtare kombëtare.
 - i. j. Kur shkel rregulloren Teknike dhe atë të Brëndëshme, kur fillon lojën me vonesë, kur nuk zbaton detyrat e tij para dhe pas ndeshjes, kur paraqitet me uniformë jo të rregullt, kur lejon lojtarë me uniformë që është në kundërshtim me rregulloren, kur vonon informacionin, kur dërgon me vonesë ose humb protokollin e ndeshjes, pezullohet 3 ndeshje.
- 9.9.6** Një gjyqtar i çdo kategorie që kalon trajner apo lojtar pranë një klubi sportiv në kategorinë e I, të Rinj e të Reja, meshkuj e femra, nuk ka të drejtë të aktivizohet për sa kohë është trajner apo lojtar.

KAPITULLI X

KATEGORIZIMI I GJYQTARËVE

10 FVK ka të drejtë të japë kategoritë e gjyqtarëve dhe të pajisë çdo gjyqtar me licencë sipas kategorisë përkatëse.

10.1 1 FVK jep dy kategoritë si më poshtë:

- a. Gjyqtar i Kat. I
- b. Gjyqtar i Kat. II

10.1.2 2 Titulli gjyqtar i Kategorisë I-rë jepet me propozim të Komisionit Tekniko- Arbitral dhe miratohet nga Bordi i FVK-se. Pas përfundimit të kursit teoriko – praktik për këtë qëllim.

- a. Miratimi për marrjen e Kat. II - të do të bëhet vetëm pas përfundimit me sukses të kursit për gjyqtarë dhe plotësimit të 2(dy) sezoneve sportive të aktivizimit të tij si gjyqtar loje.
- b. Propozimi për marrjen e Kat. I-rë do të bëhet vetëm pas përfundimit me sukses të kursit për gjyqtarë dhe plotësimit të 3(tre) sezoneve sportive të aktivizimit të tij si gjyqtar loje.

10.2 Pranimi për gjyqtar i bëhet atij personi që ka mbaruar detyrimisht, arsimin e lartë ose është student pranë një universiteti publik ose privat nuk është trajner aktiv ose lojtar aktiv, pjesmarrës në veprimtaritë zyrtare të FVK dhe me moshë jo më shumë se 35 vjeç. Prioritet do të kenë gjyqtaret femra.

10.3 FVK (Shoqata e gjyqtareve) merr përsipër organizimin e kurseve për gjyqtarë të cilët kërkojnë të fitojnë Kategorinë e II-të dhe të I-rë.

10.4 Kurset që organizon FVK i drejtojnë lektorë dhe specialistë të fushës së gjykimin në volejball të cilët propozohen nga Shoqata e gjyqtareve dhe miratohen nga Bordi i FVK-se.

10.5 Vlerësimi i çdo kandidati do të bëhet nga Shoqata e gjyqtarëve dhe miratimi përfundimtar do të bëhet nga Bordi i FVK-se.

10.6 Licencat për çdo gjyqtar miratohen e firmosen nga Kryetari i FVK ose Sekretari i Përgjithshëm.

10.7 FVK ka në ngarkim shpenzimet për organizimin e kursit, bazës materiale, pagesën e lektorëve, drejtuesve.

10.8 Çdo kandidat që do të regjistrohet në kurset e kategorizimit duhet të paguajë shumën sipas akteve nën /ligjore (15 €).

10.9 Shpenzimet për udhëtimin, veshmbathjen, fjetjen dhe ushqimin i përballon vetë kandidati.

10.9.1 Të gjithë kandidatët duhet të kalojnë nga kategoria më e ulët e gjykimin në atë më të lartë.

10.9.2 Nuk mund të fitohet kategoria më e lartë pa patur më parë kategorinë më të ulët.

10.9.3 Të drejtën për të drejtuar ndeshje zyrtare volejboli e ka çdo arbitër në Republikën e Kosovës i cili është i rregjistruar, liçensuar në FVK dhe me moshë deri 60 (gjashtëdhjetë) vjeç.

10.9.4 Moshë llogaritet sipas vitit të lindjes.

10.9.5 Bordi ka të drejtën, që për të gjithë personat zyrtarë, të caktuar për të marrë pjesë në veprimtari të zyrtare por që janë mbi moshën e përcaktuar në këtë rregullore, të vendosë rast pas rasti aktivizimin e tyre, kur aktivizimi i tyre është në dobi të mbarëvajtjes së aktiviteteve. zyrtare kombëtare e ndërkombëtare të volejbollit

1.1.6 Shoqata e gjyqtareve ka të drejtën të propozojë kandidaturat e gjyqtarëve që do të marrin pjesë në kurset e kualifikimit ndërkombëtar, sipas kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga FIVB.

1.1.7 Të gjitha kandidaturat për pjesëmarrje në kualifikimet ndërkombëtare miratohen nga Bordi i FVK.

10.10 Kriteret për t' u rregjistruar si Gjyqtar Volejboli i FVK:

1. Të ketë arsim të lartë ose të jetë student duke e vazhduar atë,
2. Të mos ketë qenë i dënuar për vepra penale apo i përjashtuar nga ndonjë institucion publik apo privat për abuzime dhe qëndrim moral të dobët,
3. Të jetë jo më i vogël se 20 vjeç dhe jo më i madh se 35 vjeç,
4. Të mos ushtrojë njëkohësisht detyra si trajner apo lojtar,
5. Të ketë nënshtetësinë Kosovare.
6. Të ketë njohuri në gjuhën Angleze
7. Të njohë përdorimin e disa programeve në kompjuter,

10.11 1 Prioritet do të kenë ish volejbollistë, ish trajnerë, mësues të edukimit .

10.12 2 Bordi I FVK dhe Shoqata e gjyqtareve përcaktojnë programin dhe personat që do të mbajnë kursin për gjyqtarët e volejbollit për çdo vit, për rinovimin e liçensës së kategorië së I-rë, si gjyqtar. Të gjithë gjyqtarët janë të detyruar të marrin pjesë në kursin e rinovimit të liçensës për të rifituar kategorinë e parë si gjyqtar. Kursi do të jetë teoriko – praktik. Gjyqtari që nuk do të marrë pjesë në kursin për gjyqtarë nuk do t' i rinovohet liçensa për aktivizimin e tij në aktivitetet zyrtare të volejbollit.

10.12.1 Të gjithë gjyqtarët që kanë fituar titullin “gjyqtar ndërkombëtar” janë të detyruar një herë në 2 (dy) vjet të marrin pjesë në kurset e e rikualifikimit për rinovimin

e liçensës zyrtare të FVK. Kryetari dhe Bordi kanë të drejtë t' i propozojnë Komisionit ERC në CEV, për pezullimin e titullit "ndërkombëtar" për një periudhë të caktuar, në rast të mos pjesëmarrjes së tyre në kursin e rikualifikimit, për rinovimin e liçensës.

10.12.2 Pas përfundimit të çdo kursi kualifikimi dhe rikualifikimi FVK lëshon dëshminë respektive. Dëshmia bazuar në rezultatet e kursit firmoset nga Kryetari dhe sekretari i përgjithshëm.

10.12.3 Për çdo kategori tjetër të drejtën e liçencës respektive e lëshon Vetëm Kryetari dhe sekretari i përgjithshëm, bazuar në kushtet e kësaj rregullore.

KAPITULLI XI

KATEGORIZIMI I TRAJNERËVE

NENI 11. FVK ka të drejtë të japë kategoritë përkatëse të trajnerit të volejbollit dhe për këtë çdo trajner pajiset me liçencën përkatëse.

11.1 FVK akordon tre kategoritë për trajnerë si më poshtë:

- a. Trajner i kategorisë së PARË
- b. Trajner i kategorisë së DYTË
- c. Trajner i kategorisë së TRETË

11.2 Për skuadrat e fëmijve deri në moshën 14 vjeç propozohet trajner i kategorisë së tretë, pas plotësimit të një sezoni sportiv si trajner me këto moshë.

11.3 Për skuadrat e para të Rinjve, para të Rejave, të Rinjve dhe të Rejave deri në moshën 18 vjeç propozohet trajner i kategorisë së dytë, pas plotësimit të një sezoni sportiv si trajner me këto moshë.

11.4 Për skuadrat e të Rriturve e të Rriturave mbi moshën 18 vjeç e lart propozohet trajner i kategorisë së parë, pas plotësimit të dy sezoneve sportive si trajner me këto skuadra.

11.5 Trajner të kategorisë ndërkombëtare e akordon Federata Botërore e Volejbollit (FIVB) në përputhje me kërkesat e niveleve të ndryshme të caktuara prej saj.

11.6 Për çdo kategori të drejtën e licencës respektive e jep vetëm FVK sipas një programi të miratuar prej saj.

Çdo vit FVK , organizon dhe zhvillon kurse për kategorizimin e trajnerëve dhe i vlerëson ata mbi bazën e programeve të caktuara, duke dhënë dhe kategoritë përkatëse.

Kohëzgjatja e kurseve është në vartësi të programeve që do të zhvillohen në përputhje me kategoritë e ndryshme.

11.7 Kurset i zhvillojnë pedagogë të volejbollit, specialistë, trajnerë, mësues të klasave sportive të volejbollit të cilët i propozon Komisioni Teknik i FVK dhe i miraton Bordi i FVK-se.

11.8 Vlerësimin për çdo kandidat e bën pedagogu i lëndës përkatse dhe vlerësimin e përgjithshëm e bën komisioni i caktuar nga FVK. Ky komision ja përcjell dokumentacionin përkatës Komisionit Teknik të FVK.

11.9 Liçencat e trainerëve të Kat. I dhe të II duhet të rinovohen çdo 4 vjet mbi bazën e kualifikimit. Ato miratohen dhe firmosen nga Kryetari i bordit të FVK-se dhe Sekretari i Përgjithshëm.

11.9.1 FVK ka në ngarkim shpenzimet për organizimin e kursit të kategorizimit, bazës materiale, pagës së lektorëve, metodistëve dhe drejtuesve.

11.9.2 Çdo kandidat që do të rregjistrohet në kurset e kategorizimit duhet të paguajë shumën sipas akteve nën ligjore 50 €.

11.9.3 Të gjitha shpenzimet për udhëtim, veshmbathje, fjetje e ushqim i ka në ngarkim kandidati.

11.9.4 Kandidatë me diplomë të arësimit të mesëm kanë të drejtë të marrin vetëm Kat. III dhe të II sportive. Përparësi do të kenë volejbollistët dhe sportistët.

11.9.5 Të gjithë kandidatët duhet të kalojnë nga Kategoria më e ulët deri në Kategorinë e I-rë. Nuk mund të fitohet Kategoria më e lartë pa patur më parë Kategorinë më të ulët.

11.9.6 Të gjithë trajnerët që marrin Çertifikatën e Nivelit të II-të FIVB fitojnë Kategorinë e I-rë si trajner, vetëm kur ata punojnë si trajnerë pranë ekipeve të volejbollit.

KAPITULLI XII

DOKUMENTACIONI I KLUBEVE, SHOQATAVE SPORTIVE, TRAJNERËVE DHE GJYQTARËVE.

NENI 12. Çdo Klub duhet të ketë dhe të dorzojë në FVK në fillim çdo sezoni sportiv, formularët model të FVK të kërkuara sipas kësaj rregullore:

1. Formularin e Rregjistrimit dhe Garancisë. E shoqëruar me kontratën respektive të Noterizuar
2. Listën e Rregjistrimit (federimit) të skuadrës. Te nenshkruar identikisht nga çdo lojtar
3. Kontratat e noterizuara të lojtarëve me të gjitha moshat

4. Çertifikatat Mjeksore për çdo lojtar dhe trajner
5. Çertifikatën e Transferimit të lojtarit.
6. Siguracionin e jetës për çdo lojtar.
7. Listën e personave antarë të skuadrës, si zyrtarë, menaxharë, sponsorë.

12.1 Klubi duhet të ketë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Statutin dhe Rregulloren e brëndëshme të FVK.
- Rregulloren Teknike të FVK. (model I FIVB)
- Rregulloren Zyrtare të zhvillimit të aktiviteteve të sezonit sportiv. Rregulloren teknike të Beach – Volleyball-it Të gjithë korrespondencën zyrtare me FVK.
- Kontrata apo akt marrëveshje të ndryshme që kanë lidhje me veprimtaritë zyrtare të volejbollit.
- Kontratat individuale të lojtarëve/ve me klubin apo shoqatën e tyre, si dhe akt marrëveshje të ndryshme që kanë lidhje me veprimtaritë zyrtare të volejbollit.

12.2. Trajnerët duhet të kenë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Programin e stërvitjes së skuadrës.
- Planin perspektiv disa vjeçar.
- Planin organizativ vjetor të ndeshjeve dhe stërvitjes.
- Planin grafik vjetor të stërvitjes.
- Planin javor të shpërndarjes së ngarkesave stërvitore.
- Planin ditor të stërvitjeve.
- Evidencën e kontrollit të stërvitjeve.
- Evidencën e frekuentimit të stërvitjeve.
- Evidencën statistikore të ndeshjeve.
- Evidencën e përgatitjes teorike. •Evidencën e lojtarëve të perspektivës dhe lojtarët e talentuar.

12.3 Listat e federimit të skuadrave pjesëmarrse në veprimtaritë zyrtare kombëtare përmbajnë këto të dhëna:

Emër Mbiemër, datë lindja, vënd lindja, vënd banimi, lartësia trupore, pesha, lartësia e prekjës maksimale, lartësia e prekjës me dy duar, kombësia, nr. liçencës, firma e lojtarit.

12.4 Listat e federimit nënshkruhen nga çdo lojtar. Për lojtarët që nuk kanë firmosur listën e federimit brënda afateve të përcaktuara, do të konsiderohen të pa federuar dhe nuk mund të pajisen me liçencë për t'u aktivizuar në ndeshje.

12.5 Listat e federimit pasi të jenë të firmosura nga mjeku zyrtarizohen (firmë + vulë) nga Kryetari ose Sekretari ekzekutiv i Klubit sportiv.

12.6 Në listat e federimit shënohen trajnerët dhe zv/trajnerët të cilët miratohen nga FVK për të drejtuar skuadrën në ndeshje.

12.7 Lojtarët e skuadrave për fëmijë aktivizohen në veprimtaritë e tyre vetëm kur lista emërore e skuadrës së tyre të jetë e firmosur dhe vulosur nga Klubi / Shoqata Sportive,

GJYQTARËT

12.8 Komisionet e gjyqtarëve apo çdo gjyqtar në mënyrë individuale duhet të ketë dhe të depozitojë në FVK 30 ditë para fillimit të çdo sezoni sportiv, formularët model të FVK –së të kërkuara sipas kësaj rregullore:

1. Formularin e Rregjistrimit (federimit) të gjyqtarit, kolektive apo individuale të nënshkruar identikisht nga çdo gjyqtar me të dhënat e kërkuara sipas kësaj rregullore.
2. Çertifikatat Mjeksore për çdo gjyqtar,
3. Siguracionin e jetës për çdo gjyqtar,
4. Licencimin për çdo gjyqtar sipas tarifave të parashikuara në këtë rregullore

12.9 Gjyqtarët duhet të kenë dokumentacionin që përmban rregullorja Teknike dhe rregullorja e brendëshme, të gjitha ndryshimet përkatëset bëra në këto rregullore, si dhe udhëzimet e dërguara me shkrim nga FVK .

12.9.1 Lista e federimit e gjyqtarëve pjesmarrës në veprimtaritë zyrtare kombëtare ku përfshihen arbitrat e Kat.I, Kat.II dhe III duhet të jetë e miratuar nga sekretari i përgjithshëm i FVK. Ajo duhet të përmbajë këto të dhëna:

Emër Mbiemër, datë lindja, vënd banimi (adresa e plotë), profesioni, vëndi i punës, arësimi përkatës, gjuha e huaj, kategoria sportive, numri i telefonit dhe adresa e e-mail.

12.9.2 Lista e federimit e gjyqtarëve do të firmoset nga çdo gjyqtar, zyrtarizohet nga Shoqata e gjyqtareve dhe miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm i FVK

KAPITULLI XIII

EKIPET KOMBËTARE

NENI 13. Ekip Kombëtar quhet skuadra e zgjedhur nga FVK dhe e autorizuar që të përfaqësojë Kosovën në të gjitha veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare dhe miqësore.

13.1 Ekipe Kombëtare që kanë të drejtë të përfaqësojnë Kosoven janë:

- | | | |
|----|-----------------------------|------------------------|
| 1. | Ekipi Kombëtar meshkuj | (Të Rritur) |
| 2. | Ekipi Kombëtar femra | (Të Rritura) |
| 3. | Ekipi Kombëtar meshkuj | (Të Rinj) |
| 4. | Ekipi Kombëtar femra | (Të Reja) |
| 5. | Ekipi Kombëtar meshkuj | (Para të Rinj) |
| 6. | Ekipi Kombëtar femra | (Para të Reja) |
| 7. | Ekipi Kombëtar i Veteranëve | (deri 50 vjeç) |
| 8. | Ekipe e Beach - Volley | (për të gjitha moshat) |

13.2 Ekipe Kombëtare kanë të drejtën e trajtimit të diferencuar gjatë periudhës së përgatitjes, para veprimtarive ndërkombëtare.

13.3 Trajnerët e Ekipeve Kombëtare propozohen nga Këshilli Profesional dhe miratohen nga Bordi i FVK.

13.3.1 Trajnerët e ekipeve Kombëtare janë të detyruar të nënshkruajnë në FVK kontratën përkatse individuale të vlefshme për 1 vit ose 6 muaj.

13.3.2 Trajnerët e I-rë të ekipeve kombëtare për të Rritur dhe të Rritura zgjidhen për një periudhë prej 2 (dy) sezone sportive.

13.3.3 Trajnerët e I-rë të ekipeve kombëtare për të Rinj, të Reja, para të Rinj dhe para të Reja zgjidhen para çdo aktiviteti ndërkombëtar ku është konfirmuar pjesëmarrja.

13.3.3 Kryetari dhe Bordi kanë të drejtën të ndryshojnë trajnerin e I-rë të ekipeve kombëtare, në rastet e mëposhtme:

- a. Kur trajneri nuk arrin të realizojë asnjë nga objektivat e përcaktuara,
- b. Kur trajneri nuk realizon seancat stërvitore në përputhje me programin dhe planin e caktuar,
- c. Kur trajneri nuk ndërton marrëdhënie korrekte me lojtarët e ekipit kombëtar,
- d. Kur trajneri nuk respekton dhe nuk zbaton udhëzimet e Bordit të FVK,
- e. Kur trajneri thyen rregullat e lojës dhe dënohet për mosrespektim të tyre,
- f. Kur trajneri nuk dorëzon në rregull bazën materiale ose abuzon me të,
- g. Kur trajneri bën sulme e shpifje publike kundër personave zyrtarë të FVK.

13.4 Trajnerët e ekipeve Kombëtare janë të detyruar, për çdo aktivitet zyrtar ndërkombëtar të nënshkruajnë në FVK kontratën individuale respektive.

13.5 KRITERET PËR ZGJEDHJEN E TRAJNERËVE TË EKIPEVE KOMBËTARE

1. Të ketë kategorinë e I-rë sportive në volejboll të miratuar nga FVK ose kategori të fituara në kurse zyrtare të organizuara nga FIVB, CEV ose federata homologe.
2. Të njohë një nga gjuhët zyrtare të FIVB dhe CEV (anglisht ose frëngjisht duke paraqitur dëshminë respektive).
3. Të jetë me moshë nga 25 deri 65 vjeç (mosha do të llogaritet sipas vitit të lindjes).
4. Të përfaqsojë dhe të mbështesë me dinjitet politikën e objektivat e Volejbollit të FVK-së.
5. Të paraqesë programe stërvitore duke parashikuar objektiva të qarta për përgatitjen fizike, teknike, taktike dhe rezultatin e ekipit që do të drejtojë, si dhe relacionin me shkrim pas veprimtarisë.

6. Të njohë rregulloren ndërkombëtare të FIVB, rregulloren e Brëndëshme të FVK, si dhe të marrë pjesë dhe të ndihmojë FVK në kurset e kualifikimit për trajnerë, të organizuara prej saj.
7. Të jetë korrekt dhe i disiplinuar në zbatimin e rregulloreve zyrtare të volejbollit.
8. Të ketë qëndrim të mirë moral dhe të jetë i padënuar.
9. Të bashkëpunojë dhe të plotësojë çdo detyrë të ngarkuar nga Këshilli Profesional, Drejtori i Reprezentacioneve, Sekretari i Pergjithshem dhe Bordi i FVK-se.
10. Të jetë i aftë fizikisht dhe në gjëndje të mirë shëndetsore.

Neni 13.6 Lojtarët apo trajnerët që thirren nga FVK në Ekipe Kombëtare janë të DETYRUAR të paraqiten pranë ekipeve Kombëtare respektive.

Neni 13.7 FVK njofton zyrtarisht klubet për vendimin mbi caktimin e trajnerëve dhe lojtarëve të ekipeve Kombëtare.

Neni 13.8 Lojtarët apo trajnerët të cilët janë caktuar për të qenë pranë ekipeve Kombëtare dhe LARGOHEN nga ekipet Kombëtare për motive personale të pajustificuara, përjashtohen për një periudhë prej 2 vitesh nga Ekipet Kombëtare, si dhe NUK LEJOHEN TË AKTIVIZOHEN ME ASNJË SKUADËR SI BRËNDA VENDIT ASHTU DHE JASHTË VENDIT.

13.9 Trajnerë të ekipeve Kombëtare mund të zgjidhen dhe trajnerë Kosovar të cilët punojnë si trajnerë jashtë shtetit, si dhe trajnerë me nënshtetësi të huaj.

13.9.1 Të gjithë lojtarët e Ekipeve Kombëtare duhet të kenë nënshtetësinë Kosovare.

13.9.2 Lojtarët e ekipeve kombëtare do të zgjidhen duke patur parasysh nënshtetësinë, moshën, seksin, gjëndjen shëndetsore, seleksionimin dhe testimin e tyre.

KAPITULLI XIV

RREGULLI UNIK I FVK-se

NENI 14. Bordi i FVK kanë të drejtën në çdo kohë, të miratojnë zyrtarisht vendime për ndryshime të nevojshme, për nene të veçanta të kësaj rregullore ose vendime për ndryshime të veçanta të cilat nuk janë parashikuar në këtë rregullore.

14.1 1 Në përputhje me nenin (14) Bordi ka të drejtë të marre vendime të karakterit organizativ, administrativ, teknik dhe disiplinor, për çdo klub, lojtar, trajner, zyrtar apo gjyqtar, me qëllimin e zbatimit të Rregulloreve të Volejbollit, Kodit të Etikës dhe Disiplinës, si dhe me qëllimin e përmirësimit të cilësisë së organizimit të veprimtarive të volejbollit dhe forcimit të marrëdhënieve miqësore ndërmjet Klubeve e Shoqatave Sportive në Republikën e Kosovës.

14.2 2 Të gjitha vendimet në përputhje me nenet e mësipërme (14 dhe 14.1) do t' i bashkëngjiten Rregullores së Brëndëshme dhe janë në fuqi deri në përfundim të çdo sezoni sportiv.

14.3 3 Të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet klubeve dhe individëve ndërmjet tyre do të shqyrtohen në FVK, vetëm në rastet kur ato paraqiten zyrtarisht nga klubi, në përputhje me nenet e kësaj rregullore.

14.4 4 Të gjitha klubet janë të detyruara të bëjnë kontrata të noterizuara me lojtarët e tyre dhe duhet t' i depozitojnë ato në FVK, në çdo fillim të ri sezoni sportiv. Kontratat për moshat nga 14-18 vjeç (nënshkruhen nga prindi ose kujdestari me ligj) dhe 18 – 30 vjeç (nënshkruhen nga vetë lojtari / ja) .

14.5 5 Të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet Klubeve në lidhje me transferimin e lojtarëve brënda vendit apo jashtë shtetit, do të merren parasysh vetëm atëhere kur Klubi ka kontratë të noterizuar me lojtarin-en ose te portokoluar në FVK. Kontratat te cilat nuk jane te protokoluara ne FVK nuk merren parasysh.

14.6 6 Të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet klubeve dhe individëve ndërmjet tyre dhe me FVK, do të zgjidhen në Komisionin e Arbitrazhit Sportiv (KAS) pranë KOK.

FUND

Rregullorja hyn ne fuqi menjeher, ajo paraprake shfuqizohet.

Prishtine, 21.09.2016

Kryetari I Bordit te FVK-se
Abedin Ibrahim

